



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 139 prot.

Kamëz, më 20.11 2023

V E N D I M

Nr. 96, datë 20.11.2023

PËR

MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT DHE LISTËN E DOKUMENTAVE PËR PROGRAMIN E "SUBVENCIONIMIT TË QIRASË" PËR FAMILJET QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË PËR VITIN 2024"

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2023, pasi mori në shqyrtim Projektvendimin Nr.70 Datë 14.11.2023, Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", të ndryshuar; Ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar; Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave "Për normat e strehimit"; Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 31, datë 18.11.2019 "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit"; **Këshilli Bashkiak Kamëz;**

V E N D O S I :

1. Sistemin e pikëzimit dhe listën e dokumentave për programin e Strehimit Social "Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë", për familjet që nuk mund të përballojnë dot qiranë në tregun e lirë për vitin 2024"
2. Mënyra e vlerësimit dhe llogaritjes së sistemit të pikëzimit do të bëhet sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të ngarkojë Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Sektorin e Strehimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Perfekti i Qarkut Tiranë

